



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I INFERMIERIT TË SHQIPËRISË

Relacion Për Projektvendimin Për Buxhetin e Vitit 2026

Urdhri i Infermierit të Shqipërisë ka patur bashkëpunim shumë të mirë me institucionet publike dhe private, veçanërisht me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si dhe me urdhrat profesionalë në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit ligjor dhe zhvillimeve në sektor.

Objektivat e vitit 2026

Analiza e projektvendimit të buxhetit për vitin 2026 tregon se institucioni ka planifikuar një nivel të qëndrueshëm të të ardhurave, të mbështetur kryesisht në kuotat e anëtarësimeve, tarifat për lejet e ushtrimit të profesionit, rinovimet e licencave dhe të ardhurat nga praktika profesionale. Struktura e të ardhurave vijon të mbështetet në burime të konsoliduara ndër vite, duke reflektuar një vazhdimësi të aktivitetit institucional dhe të bazës së anëtarësisë. Parashikimet për të ardhurat nga lejet e reja janë ndërtuar mbi bazën e numrit të pritshëm të profesionistëve të rinj që hyjnë në sistem, duke u mbështetur në përvojën e viteve të fundit.

Hartimi për Projekt-Buxhetin e vitit 2026

Ky projekt-buxhet mbështetet mbi:

- analizën krahasuese të ecurisë financiare ndër vite;
- numrin ekzistues të anëtarëve aktivë dhe kuotat e anëtarësisë;
- pritshmëritë për hyrjet e reja në profesion dhe aplikimet për leje ushtrimi profesioni;
- numrin e praktikantëve dhe ecurinë historike të praktikës profesionale;

- nevojat administrative dhe operative të institucionit për zhvillimin normal të aktivitetit;
- detyrimet ligjore që lidhen me pagat, sigurimet shoqërore, tatimet dhe detyrimet e tjera ndaj të tretëve;

Analizë

- Projektbuxheti i vitit 2026 parashikon rritje të shpenzimeve të aktivitetit, duke reflektuar zgjerimin e nevojave administrative dhe funksionale të institucionit.
- Pjesa më e madhe e investimeve lidhet me pajisjet e zyrave, riparimet dhe mirëmbajtjen, duke synuar rritjen e eficiencës administrative.
- Përfundimi i pagesave për objektin e zyrave paraqet vazhdimësi të angazhimeve të mëparshme institucionale.
- Likuidimi në kohë i detyrimeve financiare ndaj punonjësve, institucioneve shtetërore dhe palëve të treta tregon disiplinë financiare dhe qëndrueshmëri administrative.

Zbatimi i buxhetit do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

DREJTORI BURIMEVE NJEREZORE DHE I FINANCES

Xhevdet USHE